

Çfarë po Ndodh në Shkollat Publike të NYC

Shiko këtë dokument në shqip | عرض هذه الوثيقة باللغة العربية | এই নথিটি বাংলা ভাষায় দেখুন
 Consultez ce document en français | Gade dokiman sa a an kreyòl ayisyen | 查看本文件的中文版
 이 문서를 한국어로 보십시오 | Consulte este documento en español | Документ на русском языке
 اس دستاویز کو اردو میں ملاحظہ کریں | Переглянути цей документ українською мовою | Ushbu hujjatni ichida ko'ring O'zbek

schools.nyc.gov/MessagesForFamilies

Tetor 2025

Ky përditësim nga New York City Public Schools (Shkollat Publike të Qytetit të Nju-Jorkut) (NYCPS) përfshin datat e rëndësishme të kalendarit për vitin shkollor 2025–26, informacion mbi pranimet e ardhshme, takimet mes prindërve dhe mësuesve, përgatitjen për mësimin në distancë, kërkesat për vaksinim dhe politikën e re për pajisjet elektronike.

Përmbajtja

- **Data të ardhshme të rëndësishme**
- **Pranimet në shkollat e mesme të larta për vitin 2026**
- **Pranimet në shkollat e mesme të ulëta për vitin 2026**
- **Kujtesë për rregulloren e re për pajisjet celulare dhe elektronike**
- **Takimet mes prindërve dhe mësuesve gjatë muajit nëntor**
- **Përgatitja për Mësimin në Distancë**
- **Qëndrimi të përditësuar në lidhje me vaksinimet e fëmijës suaj**
- **Informimi në lidhje me NYC Public Schools (Shkollat Publike të NYC)**

Data të ardhshme të rëndësishme

- **2 tetor:** Yom Kippur, shkollat të mbyllura
- **13 tetor:** Dita e Trashëgimisë Italiane/Dita e Popujve Autoktonë, shkollat të mbyllura
- **20 tetor:** Diwali, shkollat të mbyllura
- **4 nëntor:** Dita e zgjedhjeve, nuk ka mësim për nxënësit në NYCPS
- **6 nëntor:** Takimet mes prindërve dhe mësuesve (PTC) pasdite/në mbrëmje për shkollat fillore*
- **11 nëntor:** Dita e Veteranëve, shkollat të mbyllura
- **13 nëntor:** Takimet mes prindërve dhe mësuesve (PTC) pasdite/në mbrëmje për shkollat e mesme të ulëta dhe shkollat D75*
- **20 nëntor:** PTC në mbrëmje për shkollat e mesme të larta, K-12 dhe 6-12
- **21 nëntor:** PTC pasdite për shkollat e mesme të larta, K-12 dhe 6-12*

*Nxënësit në këto shkolla e mbarojnë mësimin tre orë më herët

Pranimet në shkollat e mesme të larta për vitin 2026

Duke filluar nga data **7 tetor**, nxënësit që janë aktualisht në klasën e tetë dhe ata që regjistrohen për herë të parë në klasën e nëntë mund të marrin pjesë në **procesin e aplikimit për shkollën e mesme të lartë** në NYCPS.

Aplikimet për shkollën e mesme të lartë në vjeshtën e vitit 2026 do të mbyllen të **mërkurën, më 3 dhjetor**. Mësoni më shumë në schools.nyc.gov/HS

Testi Dixhital për Pranimin në Shkollat e Mesme të Specializuara (SHSAT)

Këtë vjeshtë, SHSAT - provimi i pranimit i kërkuar për t'u pranuar në një nga tetë shkollat e mesme të specializuara të NYC - për herë të parë do të administrohet në mënyrë dixhitale. Nxënësit që dëshirojnë të japin testin SHSAT në nëntor duhet të regjistrohen për testin midis **7 tetorit** dhe **31 tetorit**. Mësoni më shumë rreth kalimit në testimin në kompjuter dhe aksesoni materiale praktike në internet në schools.nyc.gov/SHSAT. Për informacion rreth shkollave të mesme të larta të specializuara, vizitoni schools.nyc.gov/SHS.

Pranimet në shkollat e mesme të ulëta për vitin 2026

Duke filluar nga **e mërkura e datës 15 tetor**, nxënësit që janë aktualisht në klasë të pestë (ose në klasë të gjashtë, për nxënësit në shkollat fillore K-6) mund të marrin pjesë në pranimet për shkollat e mesme të ulëta të vjeshtës së vitit 2026. Aplikimet për shkollën e mesme të ulët në vjeshtën e vitit 2026 do të mbyllen të **premtën, më 12 dhjetor**. Mësoni më shumë në schools.nyc.gov/MS

Kujtesë për rregulloren e re për pajisjet celulare dhe elektronike

Mos harroni: sipas ligjit të shtetit të Nju-Jorkut, duke filluar nga ky vit shkollor, nxënësit nuk mund të përdorin celularët dhe pajisjet e tjera personale elektronike me akses në internet gjatë ditës së shkollës. Këto pajisje duhet të ruhen në një vend të sigurt, si dollap me kyç ose kuletë magnetike. Sigurohuni që të njihni dhe të respektoni politikën e shkollës suaj për ruajtjen e pajisjeve. Vizitoni schools.nyc.gov/DevicePolicy për më shumë informacion dhe përgjigje ndaj pyetjeve të shpeshta.

Takimet mes prindërve dhe mësuesve gjatë muajit nëntor 2025

Rundi i dytë i takimeve mes prindërve dhe mësuesve (PTC) për këtë vit fillon të **enjtën, më 6 nëntor**. Takimet mes prindërve dhe mësuesve (PTC) gjatë vitit shkollor 2025-26 do të zhvillohen nga distanca, megjithatë, shkollat mund të organizojnë një takim me prani fizike sipas kërkesës. Ju lutemi vini re se datat dhe oraret mund të ndryshojnë në varësi të shkollës dhe nivelit të klasës - kontaktoni me shkollën e fëmijës suaj për të konfirmuar orarin e PTC-së dhe për të caktuar takimin tuaj. Vizitoni schools.nyc.gov/ptc për këshilla dhe udhëzime.

Përgatitja për mësimin në distancë

Nëse godinat e shkollave të NYCPS mbyllen për shkak të kushteve emergjente, të gjithë nxënësit K-12 do të ndjekin mësimin nga distanca. Sigurohuni që fëmija juaj të ketë një pajisje funksionale me akses në internet në shtëpi. Nëse ju nevojitet një pajisje e huazuar nga NYCPS, kontaktoni drejtpërdrejt shkollën tuaj **tani**; mos prisni derisa të mbyllet godina Mësoni si të filloni të përdorni pajisjen e huazuar në schools.nyc.gov/NYCPSDevices.

Për mësimin në distancë, nxënësit duhet të përdorin llogarinë e nxënësit të NYCPS (schools.nyc.gov/StudentAccounts). Për ndihmë me identifikimin, vizitoni selfservice.schools.nyc ose pyesni pranë shkollës suaj. Mësoni më shumë në schools.nyc.gov/DigitalLearning

Qëndrimi të përditësuar në lidhje me vaksinimet e fëmijës suaj

Të gjithë nxënësit e NYCPS që janë nga 2 muaj deri në 18 vjeç duhet të përmbushin kërkesat e vaksinimit të shtetit dhe të qytetit për të ndjekur shkollën. Rishikoni kërkesat për vaksinat sipas klasës në

schools.nyc.gov/immunization dhe flisni me ofruesin e kujdesit shëndetësor të fëmijës suaj për të mësuar më shumë. Mund të gjeni një ofrues të kujdesit shëndetësor që i përshtatet nevojave të familjes suaj në

pndlookup.health.ny.gov.

Informimi në lidhje me NYC Public Schools (Shkollat Publike të NYC)

Shënojeni blogun *The Morning Bell* (Kambana e Mëngjesit) si faqeshënues në schools.nyc.gov/MorningBell dhe sigurohuni që të ndiqni @NYCSchools në Facebook, Instagram, X dhe YouTube për të rejat dhe burimet më të fundit për familjet në NYC!